

URDHËR
Nr. 522 , datë 1.11.2016

PËR MBYLLJEN E VEPRIMTARISË SË SHKOLLËS SË MESME JOPUBLIKE,
ARSIMI I MESËM I PËRGJITHSHËM (GJIMNAZ), “GUINNES”

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 70, të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Mbylljen e veprimtarisë së Shkollës së Mesme Jopublike, Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm (Gjimnaz), “Guinnes”.

2. Institucioni arsimor jopublik i përcaktuar në pikën 1 të këtij urdhri, ka këto detyrime:

a) Të mbyllë të gjitha detyrimet lidhur me veprimtarinë mësimore për vitin akademik 2016–2017, brenda afateve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

b) Të pajisë çdo nxënës me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm shkollor, që do të shërbejë për transferimin e tij në një institucion tjetër të arsimit parauniversitar, brenda datës 21.11.2016.

c) Të vendosë në dispozicion të njësisë arsimore vendore përkatëse, çdo informacion të kërkuar dhe të komunikojnë me to deri në plotësimin dhe mbylljen e të gjitha kërkesave të përcaktuara në këtë urdhër.

d) Të kthejë pagesat e kryera nga nxënësit për pjesën e papërfunduar të shkollimit, si dhe çdo detyrim tjetër të papërbushur që mund të kenë ndaj nxënësit.

e) Të dorëzojë në njësinë arsimore vendore përkatëse të gjithë dokumentacionin lidhur me veprimtarinë mësimore të kryer.

f) Të gjitha shpenzimet për kryerjen e procedurave për transferimin e nxënësve, në zbatim të këtij urdhri, të përballohen nga institucioni përkatës i arsimit parauniversitar jopublik.

3. Drejtoria Arsimore Rajonale Tiranë (qytet) ka për detyrë:

a) Të ngrenë brenda datës 30.11.2016, një grup pune për ndjekjen e zbatimit të këtij urdhri nga institucioni i përcaktuar në pikën 1. Grupi i punës të menaxhojë transferimin e nxënësve në institucione të tjera të arsimit parauniversitar publik ose privat.

b) Të ruajnë në arkivin e tyre dhe në vijim të arkivojnë sipas ligjit për arkivat, të gjithë dokumentacionin e dorëzuar nga institucioni, i përcaktuar në pikën 1 të këtij urdhri.

4. Ministria e Arsimit dhe Sportit të marrë të gjitha masat, sipas parashikimeve të Kodit Civil, ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, si dhe akteve ligjore e nënligjore në fuqi, për personin juridik, që përfaqëson institucionin e përcaktuar në pikën 1, i cili nuk zbaton këtë urdhër.

5. Ministria e Arsimit dhe Sportit t’i kërkojë Qendrës Kombëtare të Licencimit kryerjen e veprimeve ligjore për çregjistrimin e subjektit, që përfaqëson Shkollën e Mesme Jopublike, Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm (Gjimnaz), “Guinnes”.

6. Ngarkohen për zbatimin e urdhrit Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit Parauniversitar, Drejtoria Arsimore Rajonale Tiranë (qytet) dhe subjekti juridik përfaqësues i institucionit i përcaktuar në pikën 1 të këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT

Lindita Nikolla